



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2020

Lënda: Kthim përgjigje

**Z.** \_\_\_\_\_

I nderuar

Në vijim të kërkesës Tuaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me datë 30.10.2020, Ju informojmë si vijon:

Në lidhje me hapjen e muzeut të bibliotekës për të ringritur vlerat e gegnishtes, ju informojmë se gjatë gjithë kësaj kohe është punuar në faza të ndryshme për ngritjen e Muzeut të librit pranë bibliotekës Marin Barleti. Në radhë të parë është punuar për gjetjen dhe grumbullimin e materialeve me vlerë që do të përbëjnë thelbin e këtij muzeu. Njëkohësisht është punuar me listimin e të gjithë objekteve me vlera për trashëgiminë kulturore, ku një vend të rëndësishëm zënë librat e botuar para viteve 1600, librat e shtypur gjatë periudhës me të hershme të tipografisë, dmth nga shpikja e shtypshkronjës në Europë në vitet 1450 deri në fund të shekullit XV-të, (libra INKUNABULA), janë listuar dorëshkrime të rralla me vlera letrare dhe shkencore, të cilat janë identifikuar nga stafi i bibliotekës, harta të vjetra e të rralla, militare edhe jo, pajisje dhe orendi të vjetra të përdorura ndër vite në bibliotekë, koleksione të stampuara të vulave ndër shekuj, si dhe letra të korrespondencave historike me vlerë për qytetin tonë. Të gjithë këto reperte kërkojnë kushte tepër specifike për ekspozimin e tyre.

Nga ana tjetër është punuar për të përgatitur studimin mbi alestimin e ambjenteve të ekspozimit të vlerave të trashëgimisë kulturore të përmendura me sipër. Ngritja dhe alestimi i këtyre ambjenteve kërkon ekspertizë dhe fonde për të përfunduar këtë Muze të librit.

Stafi i bibliotekës në bashkëpunim me historianët e rrjetit muzeal të Bashkisë Shkodër kanë punuar për hartimin e tabelave shpjeguese për repertet e lartpërmendura dhe ndërkohë, në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë Shkodër po punohet për të zbatuar projektin për sistemin e sigurisë së ambjentit dhe sistemin e ndriçimit specifik të këtij muzeu.

Gjatë këtyre viteve, për shkak të problemeve të gjetjes dhe përshtatjes së një hapsirë në shërbim të muzeut të bibliotekës, herë pas here në bibliotekë janë përgatitur dhe paraqitur para publikut ekspozita me artefaktet e rralla që biblioteka ka. Ndër këto ekspozita mund të përmendim:

- Ekspozita fotografike: “Historia e Shqipërisë përmes hartave” që synonte të pasqyronte pasuritë hartografike që ndodhen në fondet e bibliotekës. Të grupuara në tematika të veçanta, 60 hartat e paraqitura synonin të pasqyronin momente të veçanta nga historia e Shqipërisë, sidomos sa i takon problemeve të përcaktimit të kufijëve territoriale. Vend të veçantë zunë edhe hartat e karakterit topografik që lidhen me qytetin e Shkodrës. Në tërësinë e hartave u paraqitën dy harta të rralla të fillim shekulli XX, krejtësisht të veçanta të emërtuara: “Shqypnia/Shqipënia” e vitit 1902 si dhe “Plan of Roads Stream and important Building”.
- Ekspozitë etnografike “Jehona e Zejeve” me elementë kostumografie e zejesh ku u paraqiten shumë artefakte dhe vegla të zejeve të traditës në zonën e Shkodrës. Qellimi i këtij aktiviteti ishte ruajtja dhe përcjellja tek brezat e ri, të disa prej zejeve tradicionale dhe njohjen me teknikat e zbatimit të tyre, në rastin konkret, gdhendja në gur e dru.

Gjithashtu këtij aktiviteti formues, ju bashkua edhe ekspozita e kuruar, e cila kishte në përbërjen e saj veglat e punës së periudhave të ndryshme historike, pjesë e pasurisë së fondeve tona muzeale.

- Ekspozitë-konferencë mbi figurën e Gjergj Kastrioti Skënderbeu si frymëzues i Rilindjes Kombëtare Shqiptare – Muzeu Historik. Gërshëtimi i kumtesave dhe ekspozitës së botimeve në shekuj për Skënderbeun, ishte një tjetër risi e aktivitetit. Ekspozita u organizua në formën e një forumi, ku u diskutuan tema rreth jetës dhe veprimtarisë së Heroit, nga stafi i muzeut dhe studiesit Simon Lufi, Marsel Nilaj, Eduard Grishaj, Fatmir Juka, Ndrëçim Mlika, Anelmo Spahija dhe Pjerin Mirdita. Në fund, publiku pati mundësinë të njihet me një ekspozitë botimesh të rralla, pjesë e pasurisë së çmuar dokumentare e artefakte.
- Në mars 2019, në kuadër të kremtimeve të 100-vjetorit të krijimit të shoqërisë “Vllaznia”, Biblioteka “Marin Barleti në bashkëpunim me Klubin shumësportësh, organizoi një ekspozitë me njësi bibliografike (libra, gazeta, revista, broshura, albume, foto etj.) që ndodhen në fondet e bibliotekës gjithashtu dhe me fonde private të qytetarëve që bashkëpunuan për këtë projekt. Ekspozita u prit me shumë interes.
- Botimi i revistës “Gegnia” - Me shumë vlerë për pasurimin e gegnishtës është botimi për vitin e tretë radhazi i botimit të revistës “Gegnia” Kjo revistë ka karakter kulturor dhe përfshin një gamë të gjërë artikujsh që kanë lidhje me gjuhën, letërsinë, artin, albanologjinë, historinë etj. Promovimi i kësaj reviste pati jehonë pozitive dhe interesi për të ishte i lartë. Revista “Gegnia” ka arritur në numërin e 11 –të të saj dhe është dërguar në botim numri 12-të i saj. Kjo revistë është e regjistruar me ISSN përkatëse,

me orientim kulturor dhe është e hapur për të gjithë shkrimtarët e rinj dhe profesionistë. Për më shumë informacion mund të kërkonte në linkun e mëposhtëm:

<http://bibliotekashkoder.com/mat.php?lang=1&idm=390&idr=31>; <http://bibliotekashkoder.com/mat.php?lang=1&idm=390&idr=31&fbclid=IéAR0oQN9DIJ35f90AfkpGwzVf7SnSk6dNdJCerZDGBC9W8WgeLMMpNz4MXgk>

Në vëmendje të Bashkisë Shkodër ka qënë rikualifikimi i fasadës së Bibiliotekës Publike “Marin Barleti”. Ndërhyrjet janë përqendruar jo vetëm në lysterjen dhe ndriçimin e godinës, por edhe në rikonceptimin e saj si një objekt interaktiv, duke e kthyer fasadën e përparme të bibliotekës një vendtakimi, qëndrimi dhe leximi: ndërtesë pa barriera, ndërtesë e hapur jo vetëm gjatë ditës por edhe natën. Instalimi i sistemit të ndriçimit bëri të mundur shfrytëzimin e hapsirave të bibliotekës edhe në ambjentet e jashtme të saj. Investimet për rikualifikimin e ambjenteve të saj të brendshme me qëllim përshtatjen e tyre për përdorim si salla të ndryshme, për projekte të ndryshme si audio libri, apo dhe sistemimi i hapsires për vendosjen e këtij muzeu vazhdon edhe këtë vit.

Në lidhje me pikën e dytë, ju informojmë se Bashkia Shkodër ka tashmë markën e saj zyrtare me emërtimin “Shkodra Tourist Official Brand”, të regjistruar zyrtarisht edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

Marka “Shkodra Tourist Official Brand” është krijuar në kuadër të projektit “Shkodra Tourist Official Brand”, financuar Bashkia Shkodër në partneritet me Programin Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) dhe zbatuar nga Mandarina Project, në kuadër të Thirrjes ë I-rë për projekt propozime.

“Shkodra Tourist Official Brand” lindi si një nevojë e kohës së sotme, e trendeve turistike gjithnjë në rritje si dhe traditës së qytetit tonë fisnik, me identitet të spikatur kulturor, të cilat duhen të ruhen dhe promovohen në vazhdim. Si i vetmi në llojin e tij në të gjithë Shqipërinë, “Shkodra Tourist Official Brand” synon të krijojë një imazh unik, identifikues, risi totale në prodhimin e suvenireve, duke sjellë zhvillim të turizmit vendas, angazhim të artizanëve shkodranë, përfshirjen e të rinjve të apasionuar pas dizajnit, duke e shndërruar këtë imazh në një brand të mirënjohur. Në kuadër të këtij projekti është konceptuar dhe dizenuar imazhi zyrtar (emri, logo), linja moderne e suvenireve, është bërë trajnimi i artizanëve për prodhimin e produkteve me brandin “Shkodra tourist official brand”, etj.

Vlera e këtij projekti në total, ku përfshin ndër të tjera edhe krijimin e markës “Shkodra Tourist Official Brand” është 3,510,000 lekë.

Kjo markë do të shërbejë si “pasaportë” dalluese e qytetit tonë për ta përcjell atë në çdo vend të botës nga ku vijnë turistët.

Siç mund të jeni në dijeni, brandimi i territorit është një proces i gjatë, i cili përfshin jo vetëm produktet arizana dhe turistike por edhe produktet bujqësore, blegtorale, akuakulturës, peshkimit, etj. Për këtë qëllim Bashkia Shkodër ka parashikuar në buxhetin

vjetor 2021 zgjerimin e llojeve të ndryshme të produkteve vendore dhe me pas promovimin e tyre “Made in Shkodra” nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë, konferenca, tryeza rajonale, etj. Kjo markë do të garantojë sigurinë, cilësinë e produkteve dhe do të jetë një hap shumë i rëndësishëm për të rritur aksesueshmërinë e produkteve në tregje të ndryshme. Në të do të përshkruhen në detaj prejardhja e produkteve dhe mënyra e prodhimit të tij.

Me respekt,